REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 368
Datë/Datum 19.11.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e dytë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 17.09.2026, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani – Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Besarta Qadraku, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Mirlinda Krasniqi, Jetmir Berisha, Burim Berisha, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Rrahim Tërrnava, Migjen Kolshi, Aida Alimi, Suhat Ademi, Dashnim Bajrami, Driton Ademi, Gjelbrim Halili, Ali Ismaili dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Etnik Berjani, Valon Murseli, Ermal Dumani, Dardane Sogojeva Shala.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Vildane Latifi - Drejtoresh e Administratës dhe Ylber Klemendi - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport,

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile.

REND DITE

1. Propozim për shqyrtimin e dytë të ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë, të nderuar të pranishëm ju falenderoj të gjithëve që ju keni përgjigjur ftesës për mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, kjo mbledhje ka vetëm një pikë të rendit të ditës: Propozimin për shqyrtimin e dytë të ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale, ky propozim ka kaluar në lexim të parë, janë mbajtur diskutimet pubike, janë bërë ndryshimet e nevojshme dhe tashmë jemi në lexim të dytë, e keni pranuar të gjithë materialin, jeni konsultuar me të, po e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Arlinda Mekolli: E përkrahim propozimin për aprovimin e ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, Lidhja Demokratike e Kosovës?

Laureat Gojnovci: Përshëndetje kolegë, drejtor prezentë dhe ju të pranishëm. Kryesues i Kuvendit të Komunës, e keni obligim të na tregoni prej kujt ka ardhur ky propozim, a ka ndonjë shkresë nga Ministria e Adiministrimit të Pushtetit Lokal, që në lexim të parë e ka pranuar këtë propozim, sepse keni shkelur Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, duke mos i respektuar afatet e thirrjes së mbledhjes së jshtëzakonshme, sa diskutime publike janë mbajtur ndërmjet këtyre dy leximeve? Është

mbledhje e jashtëzakonshme që është thirrë ditën e hënë, dje ka qenë ditë e mërkurë data 16.09.2026, kush e ka thirrë këtë mbledhje e ka ditur që dje ka qenë gjykimi i Çlirimtarëve në Hagë, pas një dite kaq të rëndë, ne duhet të merremi me këtë rregullore, këtu shihet sa na preokupojnë çështjet kombëtare të vendit tonë, kjo pikë është shumë jorelevante me atë se çka ka ndodhur dje. Nëse jeni duke u ngutur për t'i punësuar militantët e Lëvizjes Vetëvendosjes na tregoni.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Çka nënkupton termi 'Militant' për ty?

Laureat Gojnovci: Unë jam duke u munduar ta ruaj gjuhën e komunikimit dhe t'i dëshiron të më marrësh në pyetje, po të isha në vendin tend, nuk e kisha sjellë këtë propozim në Kuvend pa propozuesin, ju e dini më së miri se çka janë militantët.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne e dimë, por t'i a e dinë, sepse je duke e përdorur në foltoren e Kuvendit.

Laureat Gojnovci: Kjo është gjuhë nënçmuese e Lëvizjes Vetëvendosje, prandaj sot jemi këtu, si ndihesh pas një ditë që janë dënuar çlirimtarët, ne të merremi me sistematizim të vendeve të punës?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Shumë keq, meqenëse po flet për çlirimtarët prita dje mos ka ndonjë reagim nga t'i si Shef i Grupit Parlamentarë të LDK-së, mirëpo për çudi nuk pashë asgjë, prandaj të lutem mos e shfrytëzoni foltoren e Kuvendit për një denim, që na ka prekur në zemrat e secilit.

Laureat Gojnovci: Ju dhe Komuna e Fushë-Kosovës, nuk keni të drejtë të akuzoni askënd, sepse nuk e keni vendosur në monitor asgjë për çlimitarët, ne së bashku me veteranët e UÇK-së, kemi vendosur flamuj, sepse ju nuk e keni bërë punën tuaj. Nuk e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës, kjo bëhet për qëllim të rehatimit të të afërmve të Lëvizjes Vetëvendosje, janë duke shtuar drejtori të reja si: Drejtoria e Parqeve, këtë drejtori e ka vetëm Komuna e Prishtinës, por ajo ka park nacional dhe parqe tjera, te ne çka do të menagjoj ai drejtor? Janë shumë çështje kontestuese si nevoja e thirrjes për mbledhje të jashtëzakonshme, por këtë po e bëni që ta planifikoni në buxhet, prapë ja keni nisur dhe prapë do të përfundoni.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Duhet të mbajë një konstatim më ndryshe nga kolegu i LDK-së, e keqëpërdorët foltoren për tema tjera dhe akuzuat komunën pa të drejtë, mua më vjen keq që në leximin e parë Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk ka marrë pjesë për të dhënë kontributin e saj, sepse kemi pritur që do të jap kontribut. Kolegu tha që nuk ka nevojë të krijohet Drejtoria e Parqeve, sepse nuk kemi parqe, dy kritika ja ka bërë veti, asnjëherë qeverisja e tij, nuk është kujdesur për parqet në komunën tonë.

Migjen Kolshi: Përshëndetje për të gjithë, ku është Kryetari i Komunës që nuk vjen në mbledhje të na elaboroj se çka parasheh më këtë sistematizim të vendeve të punës, ne jemi kundër kësaj pike sepse ka shumë gabime, një drejtori shumë të rëndësishme si ajo e urbanizmit bashkohet me Drejtorinë e Pronës, aty do të ketë keqëpërdorime, sepse njerëzit e njejtë do ta bëjnë shpronësimin dhe do të japin leje për ndërtim. Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport, ndahet në dy drejtori, ajo drejtori nuk ka shumë punë, komuna nuk ka hapësirë për të gjithë punëtorët e Fushë-Kosovës, pra ne nuk e përkrahim. Na ka prek të gjithëve vendimi për çlirimtarët, deshta t'i them Kryetarit të Komunës, pse je mashtrues, sepse në këtë foltore kam kërkuar të shfaqet në monitorin e komunës

ora e pritjes, vetë Kryetari në këtë foltore më ka thënë se po, shumë shpejtë do ta vendosim orën e pritjes në monitorin e komunës, çka ndodhi, kush e ndali, Dejona Mihali apo Donika?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Është një vendim që na ka prakur të gjithëve, mos e keqëpërdorni foltorën, të lutem përmbaju në pikë të rendit të ditës.

Migjen Kolshi: Pse nuk e ka vendosur oren e pritjes, pasi që vetë ma ka konfirmuar në këtë foltore, është dashur ta vendos se paku për dy anëtarët e Kuvendit që i ka, kjo mbetet në ndërgjegjen morale të tij.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë z. Migjen Kolshi, monitori ka pasur probleme teknike, për atë arsye nuk ka mundur të shfaqet ora e pritjes, jemi mundur ta rregollojmë që së paku ditën e fundit të shfaqet, por s'kemi mundur ta rregullojmë, këtu ka qenë problemi.

Ali Ismaili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, nuk jemi kundër këtij riorganizimi por si Kuvend i Komunës, duhet t'i sqarojmë disa gjëra para se të hidhet në votim, kur mbahen debatet publike asambleistët informohen me mesazhe ose email, që të marrin pjesë jo vetëm përmes një thirrje, sepse këtë thirrje që e keni bërë ju si Lëvizje Vetëvendosje për 15 vite nuk e keni pranuar, madje as tubimet në sallë të Kuvendit për thirrje publike nuk i keni pranuar, keni thënë se duhet të pyesin qytetarët nëpër ambiente të ndryshme por jo në Kuvend. Debatet publike po na ikin, sepse nuk po e dimë kur po mbahen, po vazhdoni me ritmin e njejtë, sepse po të ishte ndryshe këtu tani Kryetari ose Nënkryetari do të ishin prezentë sot, kjo situatë është për keqë ardhje. Në këtë rregullore keni thënë se po i fshini disa nene, nuk na keni sqaruar arsyen, pse po i fshini ato nene, ju e dini Kuvendi është organi më i lartë dhe duhet të jeni të përgatitur. Nuk kemi tabelë krahasuese të riorganizimit në përgjithësi, janë disa tabela që i ka sjellë sponzoruesi i kësaj pike të rendit të ditës dhe keni thënë që Drejtoria e Kadastrit do ta ketë një, sektori për kadastër një, zyra e lartë kadastër dy e tjera, do të beni profesionalistë 1 dhe 2, një rioraganizim është votuar, që e kemi bërë në vitin 2024 dhe kemi qenë të zhurmshëm, pse po rritet numri i drejtorive kur sistemi i administratës po bëhet i hapur, keni qenë kundër rritjes së numrit të drejtorive, është e dhimbshme për mua që po e bëni të kundërtën e asaj që keni proklamuar sa keni qenë në opozitë. Për fund do të doja të kisha një tabelë, si do të duket riorganizmi total, sa punëtorë ka komuna, sa rritet kostoja financiare me këtë riorganizim, të bëhet krahasimi me atë të vitit 2024, arsyen pse po i bejmë këto riorganizime e mandej do ta kishim më lehtë ta votonim. Tani z. Migjen Kolshi do të mbështesë në mbledhjen e rregullt, sepse vetë Kryetari i Komunës e ka thënë atë.

Driton Ademi: Po filloj nga tema e fundit, nuk di çka mundet të ketë probleme monitori i komunës, sigurinë e ekzekutimit e keni pasur, pjesë rezervë keni, gjithë çka është në rregull vetëm se nuk ka IT. Sa kam qenë në drejtori IT-ja asnjëherë, nuk e ka kryer punën e tij, ka pasur vërejtje deri në komision disiplinor, pra nuk është problem teknik por s'ka staf. Është hera e tretë që po e përpunojmë këtë rregullore, kemi themeluar drejtori dhe nuk i kemi emëruar drejtorët, edhe aty ku i kemi emëruar, i kemi stopuar siç ka qenë me rasti me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Inovacionit, ka pasur vetëm një IT dhe asnjë zyrtar tjetër. Ende pa u zbatuar rregullorja, ne i kemi hyrë plotësim-ndryshimit, pjesa e sistematizimit të vendeve të punës, që ka të bëjë me zyrtarë publik por dalloni emërimet e drejtorëve funksionar publik dhe zyrtarë publik në administratë, ka pësuar ndyshime ende pa u implementuar, kështu që mendoj se më mirë është t'i bëjmë votat e

mjaftueshme dhe të shkojmë në ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës dhe të ju ikim rregulloreve, jam kundër asaj që të miratojmë një rregullore pas 30 shtatorit, mos me buxhetu siç kam pas rast unë kam mbetur me pak 'mallëra dhe shërbime' pak 'investime kapitale', vitin e dytë me një projekt duke i kërkuar mjetet financiare dhe vitin e tretë ka thënë kjo drejtori po shuhet, kjo është optimizmi i një qeverisje. Nëse e miratoni, e buxhetoni që së paku kjo strukturë të ecë përmes atij buxheti dhe të vazhdojë puna si duhet, te pjesa tjetër ne e dimë nivelin e debateve publike, unë nuk kam procesverbal që është mbajtur në kohën kur ka pasur debat publik, ku dikush e ka dhënë ndonjë propozim dhe të shikojmë, a ka pranuar ekipi apo jo, sepse ndoshta atyre nuk ju ka pëlqyer por Kuvendit po dhe sot do ta bënte pjesë të këtij dokumenti. Miratimin do të ja jap këtij dokumenti, shpresoj të mos ketë ankesa të zyrtarët publik, te pjesa e drejtorive do doja të kishte më shumë decentralizim, qasje më të madhe për qytetarët për shërbimet ndaj tyre.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim për aprovim në shqyrtimin e dytë 'Propozimin për ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës e aprovoi me unanimitet të pjesëmarrësve në votim 'Propozimin për shqyrtimin e dytë të ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale' dhe mori:

VENDIM

1. Për miratimin e ndryshim-plotësimit të Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale.
2. Ndryshim-plotësimit të Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale, e cekur në pikën një (1) të këtij vendimi, parasheh mënyrën e organizimit dhe rregullimin e brendshëm, përgjegjësitë e njësive organizative si dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ndryshim-plotësimi i Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale dhe Shtojca A - 1.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 10:40 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani